




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije-Ministry of Trade and Industry

SHKËMBIMET TREGTARE të KOSOVËS 2009



Korrik 2010

Raporti vjetor mbi tregtinë e jashtme të Kosovës është përgatitur nga Departamenti i Tregtisë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

Në këtë raport, burim i të dhënave për sektorin e jashtëm të Kosovës është Enti i Statistikave të Kosovës. Të dhënat e prezantuara në këtë raport përfshijnë totalin e eksportit dhe të importit të Kosovës.

Ju lutem, pyetjet dhe komentet i drejtoni në:

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Departamenti i Tregtisë

Rr. Muharrem Fejza pn.

Lagjja e Spitalit

10000 Prishtinë

Kosovë

Tel. +381 (0) 38 200 36 519

Fax. + 381 (0) 38 212 807

<http://www.mti-ks.org/>





**Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije-Ministry of Trade and Industry**

SHKËMBIMET TREGTARE TË KOSOVËS 2009

Korrik 2010

PARATHËNIE

Kriza ekonomike globale u reflektua edhe në ekonominë e Kosovës, sado që efektet e saj nuk ishin aq të dukshme si në vendet e tjera të rajonit. Së bashku me Shqipërinë, Kosova ishte vendi i vetëm në rajon që shënoi rritje ekonomike gjatë vitit 2009. Kjo ndodhi si rezultat i dy faktorëve: i nivelit të lartë të shpenzimeve kapitale, të cilat e mbajtën të fuqishme edhe kërkesën e brendshme, si dhe i nivelit të ultë të integritit të Kosovës me botën. E dyta ka të bëjë me integrimin financiar, tregtinë me jashtë, dhe mobilitetin e fuqisë punëtore apo remitencat. Është paradoksale një situatë e tillë, pasi që është dokumentuar se niveli i integritit në ekonominë botërore ka qenë shtytësi më i madh i rritjes ekonomike për ekonomitë në tranzicion¹. Mirëpo, ky integrim, i ka bërë këto vende shumë sensitive ndaj lëvizjeve në ekonominë globale; çrregullimet në sektorin financiar botëror u reflektuan në të gjithë mekanizmat kryesor të rritjes ekonomike në vendet në tranzicion dhe, për rrjedhojë, shkaktuan tkurrje të aktivitetit të gjithmbarshëm ekonomik.

Mirëpo, sado që me nivel të ultë të integritit ekonomik, siç u tha edhe më parë, Kosova u prek nga kriza. Kjo vërehet në zvogëlimin e ritmit të kredithënies, zvogëlimin e dërgesave nga diaspora, rënien e fluksit të investimeve të jashtme (ky mund të jetë gjithashtu rezultat i finalizimit të marrëveshjeve kryesore të lidhura me privatizimin) si dhe në rënien e aktivitetit eksportues. Aspekti i fundit u dokumentua edhe në këtë raport të shkëmbimeve tregtare për vitin 2009. Eksportet në vitin 2009 shënuan rënie relativisht të madhe krahasuar me vitin 2008. Rënia më e madhe u shënuar në eksportin e produkteve minerale dhe të ngjashme. Kjo ndodhi si pasojë e uljes së kërkesës për këto lloj produktesh. Mirëpo, gjatë pjesës së dytë të vitit 2009 vërehen lëvizje pozitive; rritja e çmimeve riaktivizoi ndërmarrjet në këtë sektor.

Për institucionet e Kosovës, ngritja e aktiviteteve eksportuese të ndërmarrjeve vendore mbetet ende sfidë e veçantë. Edhe gjatë vitit 2009 janë ndërmarrë hapa institucional për promovimin dhe mbështetjen e sektorit të eksporteve në Kosovë. Ka zënë fill themelimi i mekanizmeve koordinues në politikën tregtare, mekanizma këta që do të kanalizojnë të gjitha përpjekjet e aktorëve të ndryshëm të përfshirë në politikën tregtare. Më saktësisht, këta mekanizma do të angazhohen në formulimin, koordinimin, implementimin, vlerësimin dhe rishikimin e politikës tregtare. Për më tepër, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka nisur procedurat për përpilimin e strategjisë së promovimit të eksporteve. Gjithashtu, përmes Agjencisë për Promovimin e Investimeve, MTI-ja ka ndarë mjetet për misionet tregtare të prodhuesve kosovarë në Mal të Zi, Shqipëri dhe në vende të tjera. Janë këto vetëm disa nga aktivitetet, të cilat është duke i realizuar MTI-ja në koordinim me mekanizmat e tjerë, me qëllim të rritjes së eksporteve. Viti 2010 duket se do të jetë shumë më pozitiv se sa vitet paraprake sa u përket aktiviteteve eksportuese: deri në maj të 2010 Kosova ka eksportuar mbi 110 milion €. Kjo shifër është për afër 25 milion € më tepër se sa është eksportuar në vitin 2008 në po të njëjtën periudhë, vit ky që shënon eksportet më të mëdha në periudhën e pasluftës (krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2009, diferenca është shumë më e madhe, respektivisht rreth 60 milion €). MTI është e përkushtuar të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm që ky trend të përmirësohet edhe më tutje.

Lutfi Zharku, Ministër
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

¹Shih EBRD (2009). Transition Report 2009: Transition in Crisis?

Përmbajtja

Hyrje	5
1. Zhvillimet në tregtinë ndërkombëtare	5
2. Ekonomia e Kosovës dhe sektori i jashtëm	6
3. Struktura e eksporteve dhe importeve	8
3.1 Struktura e eksporteve dhe importeve sipas procedurave	8
3.2 Struktura e eksporteve dhe importeve sipas produkteve	8
3.3 Produktet më të eksportuara të Kosovës	11
3.4. Struktura e eksportit dhe importit sipas partnerëve tregtarë	12
3.4.1 Tregtia me vendet e BE-së	13
3.4.2 Tregtia me vendet CEFTA	14
3.4.3 Tregtia me vendet e tjera të botës	16
3.5 Struktura e eksporteve dhe importeve sipas pikave doganore	16
3.6 Mënyrat e transportimit të mallrave	18
3.7 Shërbimet dhe tregtia e shërbimeve	19
Përmbyllje	21

Tabelat

Tabela 1: Importet dhe eksportet sipas procedurave statistikore	8
Tabela 2: Eksporti dhe importi sipas seksioneve të sistemit të harmonizuar	9
Tabela 3: Eksportet më të mëdha të Kosovës sipas sistemit të harmonizuar	11
Tabela 4: Importet më të mëdha të Kosovës sipas sistemit të harmonizuar	12
Tabela 5: Partnerët kryesor tregtar të Kosovës	12
Tabela 6: Importet dhe eksportet sipas pikave doganore	13-16
Tabela 7: Eksportet dhe importet sipas mënyrës së transportit	17-19

Figurat

Figura 1: Bilanci tregtar i Kosovës	7
Figura 2: Eksportet më të mëdha sipas kapitujve	10
Figura 3: Importet më të mëdha sipas kapitujve	10
Figura 4: Tregjet kryesore eksportuese dhe importuese të BE-së	13-16
Figura 5: Tregjet kryesore eksportuese dhe importuese të CEFTA-s	13-16
Figura 6: Eksporti sipas përqindjes nëpër pikat doganore	17
Figura 7: Importi sipas përqindjes nëpër pikat doganore	18

Hyrje

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë edhe këtë vit ka përgatitur publikimin tradicional vjetor “Shkëmbimet Tregtare të Kosovës - 2009”. Me këtë publikim Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ofron një pasqyrë të përmbledhur të zhvillimeve kryesore në aspektin e qarkullimit tregtar të Kosovës me botën. Publikimi synon t’u shërbejë institucioneve qeveritare, komunitetit të biznesit, organizatave të tjera profesionale dhe publikut më të gjerë, duke ofruar informata të rëndësishme mbi shkëmbimet tregtare me botën.

Në fillim, ky publikim, ofron informata lidhur me lëvizjet dhe zhvillimet ekonomike dhe tregtare në botë dhe rajon, për prezantimin e një makro pasqyreje lidhur me rrjedhat ndërkombëtare, të cilat, në mënyrë direkte apo indirekte mund të kenë refleksione pozitive apo negative edhe në ekonominë e vendeve në rajon, përfshirë këtu edhe Kosovën. Në pjesën tjetër të publikimit analizohen të dhënat e qarkullimit tregtar të Kosovës gjatë vitit 2009. Qarkullimi tregtar i Kosovës analizohet dhe paraqitet përmes strukturës së eksporteve dhe importeve sipas procedurave, strukturës së eksporteve dhe importeve sipas produkteve, strukturës së eksportit dhe importit sipas partnerëve tregtarë, strukturës së eksporteve dhe importeve sipas pikave doganore si dhe strukturës së eksporteve dhe importeve sipas mënyrës së transportit të mallrave.

1. Zhvillimet në tregtinë ndërkombëtare

Ekonomia botërore tani duket se ka hyrë në një fazë të re, duke lëvizur nga një periudhë me sfida dhe kërcënime nga më të ndryshmet si rrjedhojë e krizës financiare globale, në një periudhë të rimëkëmbjes ekonomike. Gjatë vitit 2009, tregjet financiare janë stabilizuar në një masë të konsiderueshme. Në pjesën e dytë të vitit shumica e vendeve që ishin në recesion të thellë filluan të raportojnë për rritje të aktiviteteve ekonomike. Sipas Eurostatit, shtetet më të zhvilluara ekonomisht gjatë vitit 2009 kanë pasur këto lëvizje në shtimin real të GDP-së: SHBA-ja ka pasur rënie prej -2.4 për qind, Japonia prej -5.2 për qind, Gjermania -4.9 për qind, Britania e Madhe -4.9 për qind, Franca -2.65 dhe Italia -5 për qind². Gjatë vitit 2009, shtimi real i GDP-së, për 27 vendet e BE-së, ishte negativ me një shkallë mesatare prej -4.2 për qind, për dallim nga vitet paraprake ku shtimi ekonomik ishte pozitiv si p.sh. në vitin 2007 ishte 2.9 për qind dhe në vitin 2008 prej 0.7 për qind. Ndërkaq, 16 vendet e eurozonës përjetuan rënie prej -4.1 për qind të GDP-së krahasuar me shtimin prej 2.8 për qind në vitin 2007 dhe 0.6 për qind në vitin 2008. Megjithatë, periudha e fundit e vitit 2009 ka raportuar për zhvillime pozitive në ekonominë e tyre përkatëse. Rënia e vitit 2009 i atribuohet kryesisht rënies në këmbimet tregtare të vendeve të zhvilluara, importet e të cilave shënuan rënie prej 13.6 për qind ndërsa eksportet për 15 për qind.

Në anën tjetër, rënia në vendet në zhvillim dhe ato në tranzicion ishte më e ulët, respektivisht 9.6 për qind në importe dhe 6.5 për qind në eksporte. Për të gjitha këto kategori dhe grupe vendesh viti 2010 projektohet të jetë pozitiv dhe ngritja kryesore vërehet të jetë në eksporte të cilat parashihet të rriten për 1.3 për qind në vendet e zhvilluara ndërsa 1.4 për qind në vendet në zhvillim dhe ato në tranzicion.

Aktiviteti ekonomik (shkalla reale e shtimit të GDP-së) pati rënie më të theksuar në 3 vendet e Baltikut ku Letonia pësoi rënie prej -18 për qind, e ndjekur nga Lituani me -14.8 për qind, dhe Estonia me -14.1 për qind. Rënie të theksuar të aktivitetit ekonomik përjetuan

²<http://epp.eurostat.ec.europa.eu/tgm/printtable.do>

edhe disa vende të Evropës Juglindore si Sllovenia me – 7.8 për qind, Rumania me – 7.1 për qind dhe Hungaria me 6.3 për qind. Irlanda, po ashtu, pësoi rënie të shtimit të GDP-së për 7.1 për qind.

Ekonomitë e vendeve të Ballkanit Perëndimor ishin prekur po ashtu nga kriza e madhe ekonomike dhe financiare e vitit 2008. Vendet e vetme të cilat përjetuan shtim pozitiv të GDP-së ishin Kosova dhe Shqipëria. Në anën tjetër, rënie më të madhe të aktiviteteve ekonomike përjetuan Kroacia, Serbia dhe Mali i Zi. Ekonomia e Kroacisë³ në vitin 2009 pësoi rënie prej 5.8 për qind në terma real të GDP-së e shkaktuar kryesisht nga një rënie e konsiderueshme të kërkesës vendore. Në të njëjtën kohë importet pësuan rënie prej 20.7 për qind kurse eksporti pësoi rënie prej 16.2 për qind duke rezultuar me një kontribut pozitiv të neto eksportit në shtimin e GDP-së për 3.6 për qind të poenëve.

Ekonomia e Malit të Zi ishte prekur gjatë vitit 2009 nga kriza globale. GDP-ja e Malit të Zi pësoi rënie prej 5.3 për qind të shkaktuar kryesisht nga rënia e madhe në sektorët e prodhimit dhe të minierave prej 38.6 për qind respektivisht prej 65 për qind. Deficiti tregtar u zvogëlua për 33 për qind gjatë vitit 2009 duke përfaqësuar ende rreth 44 për qind të GDP-së. Zvogëlimi ishte si pasojë e rënies së madhe të importeve për 33 për qind dhe të eksportit për 35 për qind me një bazë shumë më të ulët. Aktiviteti ekonomik gjegjësisht GDP-ja e Serbisë ka rënë për 3 për qind në vitin 2009. Sektorët më të prekur ishin ndërtimtaria (-17.1 për qind), prodhimi (-15.3 për qind) dhe tregtia (-8.7 për qind). Në vitin 2009, deficiti tregtar u zvogëlua në mënyrë të konsiderueshme (-5.5 për qind të GDP-së kundrejt 17.8 për qind në vitin 2008) përkundër përqësimit të tregtisë së mallrave kah fundi i vitit. Përkundër mungesës së të dhënave më të detajuara të llogarive kombëtare për vitin 2009, aktiviteti ekonomik në Bosnje e Hercegovinë pësoi rënie prej – 3 për qind. Deficiti tregtar për vitin 2009 u zvogëlua për 27.8 për qind, që ndikoj që deficiti të jetë në nivel 7.5 për qind të GDP-së. Maqedonia, përkundër shtimit ekonomik të vitit 2008 prej 4.8 për qind, në vitin 2009 pësoi rënie, ku shtimi për tërë vitin ishte negativ – 0.7 për qind. Faktorët kryesor të rritjes ishin shtimi i konsumit privat për 0.2 për qind dhe rënie e importeve për 10.7 për qind. Përpos rënies së importeve, edhe eksportet pësuan rënie prej 8.2 për qind. Deficiti tregtar arriti nivelin e vitit 2007, duke rënë prej 13.1 për qind të GDP-së të vitit 2008 në 7.5 për qind në vitin 2009. Përkundër përvojave të këqija ekonomike të vendeve tjera të Ballkanit gjatë vitit 2009, ekonomia e Shqipërisë pjesërisht për shkak të politikave fiskale ekspansioniste përjetoi një shtim pozitiv real të GDP-së prej rreth 2.7 për qind edhe pse në një nivel shumë më të ulët se shtimet në vitet paraprake.

2. Ekonomia e Kosovës dhe sektori i jashtëm

Viti 2008, për shkak të krizës ekonomike dhe financiare ishte vit i sfidave të mëdha për ekonominë nacionale. Fatmirësisht, për shkak të konjunkturës ekzistuese ekonomike dhe financiare ekonomia e Kosovës bënte përjashtim (bashkë me Shqipërinë) të cilat përjetuan rritje ekonomike .

Trendi pozitiv në vitin 2008 krijoi parakushte që Kosova edhe në vitin 2009 ta përmbyll gjithashtu me shtim ekonomik pozitiv. Shtimi ekonomik sipas Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave të Republikës së Kosovës arriti në shkallë prej 4.4 për qind. Faktori kryesor që ndikoj në shtimin ekonomik ishte rritja e konsumit publik.


Zhvillimet kryesore ekonomike të Kosovës në vitin 2009 ishin:

- Reformimi i politikës tatimore hyri në fuqi, më 01 Janar 2009;
- Miratimi i politikës tregtare të Kosovës;
- Rënja e çmimeve prej 2.4 për qind, sipas të dhënave të BQK, konsiderohet si një ndër faktorët që ka kontribuar pozitivisht në normën reale të rritjes ekonomike në vitin 2009;
- Vazhdoi procesi i ndërtimit të infrastrukturës rrugore si një nga prioritetet kapitale të qeverisë;
- Ka vazhduar procesi i privatizimit, i cili kishte shënuar ngecje gjatë vitit 2008;
- U zhvilluan parapërgatitjet për ndërtimin e termocentralit “Kosova e Re” dhe privatizimin e distribucionit dhe rrjetit të KEK-ut, për privatizimin e PTK-së dhe koncesionimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës.

Sipas Kornizës afatmesme të shpenzimeve 2011-2013 parashihet që rritja reale e GDP-së për vitin 2010 të jetë 5.1 për qind.

Shkëmbimet tregtare të Kosovës, gjatë vitit 2009, arritën vlerën prej 2 miliardë e 100 mijë Euro që, krahasuar me shkëmbimet tregtare prej 2 miliardë e 126 mijë euro të vitit 2008, paraqet rënie prej 1.2 për qind. Importet e mallrave të Kosovës arritën vlerën prej 1,935 milionë Euro duke ndjekur një ecure vjetore të ngjashme me atë të vitit 2008 (me një rritje vjetore vetëm prej 0.37 për qind).

Figura 1. Bilanci tregtar i Kosovës (2005 – 2009, në €000)



Burimi: Enti i Statistikave të Kosovës(2009)

Kriza ekonomike globale kishte për pasojë rënien e kërkesës dhe uljen e çmimeve në tregjet ndërkombëtare, gjë e cila ndikoi edhe në tregtinë e jashtme të Kosovës. Çmimet të cilat më së shumti shënuan rënie janë çmimet e metaleve, karburanteve si dhe çmimet e produkteve ushqimore, kategori këto të cilat kanë pjesëmarrje të konsiderueshme në strukturën e përgjithshme në tregtinë e Kosovës. Eksportet e Kosovës shënuan vlerën prej 165.3 milionë Euro, apo 16.6 për qind rënie krahasuar me vitin 2008, rënie e cila ka rritur edhe me tutje bilancin negativ tregtar të Kosovës.

Kosova në masë të madhe është e varur nga importet dhe për rrjedhojë, mbulimi i importeve nga eksportet u zvogëlua në 8.5 për qind, krahasuar me 10.5 për qind, treguesin e vitit 2008.

3. Struktura e eksporteve dhe importeve

3.1 Struktura e eksporteve dhe importeve sipas procedurave

Në bazë të procedurave statistikore të dhënat tregojnë se 42.2 për qind e eksportit është eksport i rregullt ndërsa pjesa tjetër apo 53.6 për qind është riekспорт, kryesisht eksport pas përpunimit të brendshëm. Importet e rregullta përbëjnë 96.2 për qind të importeve, riimporti përfshinë vlerën prej vetëm 1.2 për qind (Tabela 1).

Tabela 1: Eksporti dhe importi sipas procedurave statistikore (2008 – 2009, €000)

	2008		2009	
	Vlera	përqind	Vlera	përqind
Gjithsej eksportet	198,464	100.0	165,327	100.0
Eksportet e rregullta	88,928	44.8	69,708	42.2
Eksportet e rregullta-rryma	8,238	4.2	6,999	4.2
Eksportet për përpunim të jashtëm	3,031	1.5	2,822	1.7
Eksportet pas përpunimit të brendshëm	98,267	49.5	85,798	51.9
Gjithsej importet	1,928,236	100.0	1,935,541	100.0
Importet e rregullta	1,829,646	94.9	1,862,148	96.2
Importet e rregullta-rryma	57,424	3.0	51,005	2.6
Importet pas përpunimit të jashtëm	2,932	0.2	1,465	0.1
Importet për përpunim të brendshëm	38,234	2.0	20,923	1.1

Burimi: Enti i Statistikave të Kosovës

Sipas të dhënave, në vitin 2009 mbi 4 për qind e totalit të eksporteve të Kosovës e përbën rryma. Rryma e eksportuar është në vlerë mbi 6.9 milion€ apo 15 për qind me pak nga viti 2008. Ndërsa në Kosovë është importuar rrymë në vlerë prej 51 milionë € apo 6.4 milionë më pak se në vitin 2008, që mbulon 2.6 për qind të importeve të përgjithshme.

3.2 Struktura e eksporteve dhe importeve sipas produkteve

Sa i përket strukturës së eksporteve sipas produkteve ato ende mbesin të njëjta si në vitet e mëparshme dhe kryesisht janë në forme të lëndës së parë dhe produkteve të papërfunduara. Eksportet janë të dominuar nga metali i papërpunuar (apo mbeturinat metalike) dhe produktet minerale. Kosova ka eksportuar mbi 113 milionë Euro të këtyre dy grupeve të produkteve, që përbën afër 70 për qind të totalit të eksporteve. Po ashtu, produktet bimore dhe ushqimore mbulojnë një përqindje të konsiderueshme të eksportit gjegjësisht 11 për qind të eksporteve të përgjithshme. Rënia e kërkesës në tregjet e jashtme për eksportet kosovare më së tepërmi u reflektua në kategorinë e metaleve bazë, që njëherit ishte kategoria më e eksportuar gjatë vitit 2009 me rreth 53 për qind të totalit të eksporteve.

Në krahasim me vitin 2008 në këtë periudhë eksportet e kësaj kategorie kanë shënuar rënie për afër 36 milionë € (apo 29 për qind), duke e rritur bilancin negativ tregtar të kësaj kategorie produktesh. Rënien e eksporteve të këtyre produkteve e shkaktoi rënia e shpejtë e çmimeve të metaleve në tregjet ndërkombëtare në fund të vitit 2008 dhe fillim të vitit 2009. Mirëpo, me stabilizimin e tregjeve ndërkombëtare, në tremujorin e fundit të vitit 2009 është shënuar ngritje e këtyre çmimeve, faktor ky i cili ndikoi në rritjen e vlerës dhe sasisë së eksporteve të këtyre produkteve (për më shumë detaje rreth trendëve, shih Tabelën në vijim dhe Figurën 2 dhe 3).

Tabela 2: Eksporti dhe importi sipas seksioneve të sistemit të harmonizuar (2009, €000)


	Eksporti		Importi		Bilanci	
	2009		2009		Diferenca	Eks/Imp
	Vlera	%	Vlera	%		
Kafshë të gjalla, prod. me origjinë kafshe	1,076	0.7	84,597	4.4	-83,521	1.27
Produkte bimore	9,484	5.7	90,034	4.7	-80,550	10.5
Yndyrëra	75	0.0	18,170	0.9	-18,095	0.41
Ushqime të përgjo. pije dhe duhan	9,356	5.7	241,566	12.5	-232,210	3.87
Produkte minerale	24,952	15.1	331,302	17.1	-306,350	7.53
Produkte të industrisë kimike	1,482	0.9	142,902	7.4	-141,420	1.04
Plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre	6,357	3.8	95,747	4.9	-89,390	6.64
Lëkurë dhe artikuj prej tyre	4,454	2.7	3,367	0.2	1,087	132
Druri dhe artikuj druri	875	0.5	44,921	2.3	-44,046	1.95
Letër dhe artikuj prej letër	1,033	0.6	45,412	2.3	-44,379	2.27
Tekstil dhe artikuj tekstili	5,241	3.2	69,089	3.6	-63,848	7.59
Veshmbathje të këmbëve	95	0.1	18,805	1.0	-18,710	0.51
Art. prej guri, allçie, prod. qer. dhe qelqi	1,240	0.8	73,464	3.8	-72,224	1.69
Perla, gurë të çmuar, met. të çmuara etj.	30	0.0	1,294	0.1	-1,264	2.32
Metale bazë dhe artikuj prej tyre	88,363	53.4	159,367	8.2	-71,004	55.4
Makineri, pajisje mekanike dhe elektrike	7,206	4.4	278,689	14.4	-271,483	2.59
Mjetet e transportit	1,620	1.0	162,215	8.4	-160,595	1
Instr. optike, mjekësore, foto etj.	529	0.3	23,091	1.2	-22,562	2.29
Armët dhe municionet	0	0.0	409	0.0	-409	0
Artikuj të ndryshëm të prodhuar	1,852	1.1	50,946	2.6	-49,094	3.64
Veprat e artit	2	0.0	145	0.0	-143	1.38
Gjithsej	165,322	100	1,935,532	100	-1,770,210	8.54

Gjatë vitit 2009 mund të vërehet rënie në eksportin e produkteve të Kosovës edhe në disa kategori të tjera. Veçanërisht lëkura dhe produktet e saj si dhe makineritë e ndryshme dhe komponentat elektronike kanë shënuar rënie të madhe të eksportit, edhe pse rënia absolute është e papërfillshme në raport me metalet bazë. Lëkura dhe produktet e saj shënuan rënie për 8 për qind në raport me vitin 2008. Po ashtu, krahasuar me vitin 2008, makineritë dhe produktet elektronike u zvogëluan për 1.6 milion € (apo 18 për qind) .

Struktura e importeve në 2009 mbetet përafërsisht e njëjtë si struktura e vitit 2008. Importet dominohen nga produktet minerale dhe kategoria e makinerive dhe paisjeve të cilat së bashku mbulojnë rreth 32 për qind të totalit të importeve. Kur është fjala për produktet minerale duhet potencuar rënien e rëndësishme krahasuar me vitin paraprak. Importi i kësaj kategorie shënoi rënie për 47 milionë € në raport me vitin paraprak (apo për mbi 12 për qind). Ndryshim vërehet në rënien e çmimeve të naftës në bursat ndërkombëtare (produkt që dominon në importet e Kosovës).


Përbërës të tjerë të rëndësishëm në strukturën e importeve janë produktet ushqimore të cilat gjatë vitit 2009 janë importuar në vlerë prej afër 241 milionë €. Edhe kjo kategori e importit të këtyre produkteve u karakterizua me rënie të ndieshme në raport me vitin 2008. Pas produkteve ushqimore radhiten mjetet e transportit me afër 162 milionë € (apo mbi 8 për qind të totalit). Mjetet e transportit kanë shënuar rritje në raport me periudhën e vitit të kaluar për afër 31 milionë € (apo 23 për qind). Pasojnë metalet bazë dhe artikujt e ngajshëm me rreth 159 milionë € (apo 8 për qind të totalit).

Figura 2: Eksportet më të mëdha sipas kapitujve (2009, €000)



Burimi: Enti Statistikor i Kosovës (2009)

Figura 3: Importet më të mëdha sipas kapitujve (2009, €000)



Burimi: Enti Statistikor i Kosovës (2009)

3.3 Produktet më të eksportuara të Kosovës

Tabela në vijim tregon strukturën e eksporteve të vitit 2009 e zbërthyer edhe në më tepër detaje. Siç shihet pozitë dominuese në produktet më të eksportuara nga Kosova zënë eksporti i nikelit me mbi 65 milionë € duke mbuluar 39 për qind të totalit të eksportit. Gjithashtu, xehet dhe koncentratet e plumbit përbëjnë një tjetër produkt të rëndësishëm eksporti. Nga ana tjetër pjesëmarrja e produkteve me bazë metal nga bakri, zinku dhe alumini kanë dominuar në eksportet e Kosovës, të cilat, së bashku mbulojnë mbi 8 për qind të eksporteve të përgjithshme, (për më shumë detaje rreth vlerës dhe pjesëmarrjes në përqindje të produkteve më të eksportuara, shih Tabelën 3).

Eksportet me te medha te Kosoves sipas sistemit te harmonizuar HS-6 (2009,€000)

Emërtimi	Vlera	Si % e importeve totale nga vendi
Ferronikel	65,374,456	39.54
Xeherore dhe koncentrate plumbi	8,170,079	4.94
Energjia elektrike	6,999,215	4.23
Kthime dhe mbetje ferrike, gize dhe çeliku	6,563,812	3.97
Zhavorr i lyer me katran për te shtruar rruge	4,957,002	3.00
Mbetjet dhe kthimet e bakrit	4,710,742	2.85
Miell gruri dhe miell meslini	3,495,450	2.11
Xeherore dhe koncentrate zinku	3,253,124	1.97
Rripat apo shiritat prej gome të vullkanizuar:	3,149,393	1.90
Mbetjet dhe kthime alumini	2,708,959	1.64

Burimi: Enti Statistikor i Kosovës (2009)

Në lidhje më produktet më të importuara në Kosovë, gjatë vitit 2009 importi i naftës dhe vajrave tjera kanë dominuar në importet e përgjithshme me pjesëmarrje prej afër 8 për qind të totalit apo mbi 147 milionë € në vlerë. Për më tepër, automjetet e transportit, energjia elektrike, cigare, çimento janë disa nga mallrat e rëndësishme në strukturën e importeve të Kosovës (shih, Tabelën. 4)

Importet me te medha te Kosoves sipas sistemit te harmonizuar HS-6 (2009,€000)

Emërtimi	Vlera	Si përqind e importeve totale nga vendi
Vajrat e naftës dhe vajrat e tjera	147,644,036	7.63
Automjete të një cilindri me kapacitet që nuk e kalon 2500 cm3:	55,389,598	2.86
Energjia elektrike	51,004,697	2.64
Vajra të lehte dhe përgatitje	43,338,497	2.24
Shufra dhe shkopinj te tjerë prej gize dhe çeliku	39,601,106	2.05
Cigare qe përmbajnë duhan	38,319,108	1.98
Çimento portland,çimento oksidalumini,etj	31,797,771	1.64
Ujërat,ujerat minerale dhe ujërat e gazuara, që përmbajnë sheqer dhe lëndë tjera aromatizuese	23,057,694	1.19
Medikamentet për përdorime terapike	20,964,643	1.08
Automjete të një cilindri me kapacitet që e kalon 2500 cm3:	20,570,872	1.06

Burimi: Enti Statistikor i Kosovës (2009)

3.4 Struktura e eksportit dhe importit sipas partnerëve tregtarë

Partnerë kryesorë tregtarë edhe në vitin 2009 mbesin vendet e BE-së dhe ato të rajonit, CEFTA (shih, tabelën 5). Një përqindje më e madhe e eksporteve dhe importeve të Kosovës në vitin 2009 ka depërtuar në tregjet e BE-së se sa në ato të vendeve të CEFTA-s. Mbi 75 për qind e importeve dhe eksporteve janë realizuar me këto grupe shtetesh gjatë vitit 2009.

Megjithatë, vërehet se për 2 – 3 për qind ka lëvizje të importit në drejtim pozitiv për BE-në dhe në drejtim negativ nga vendet CEFTA (në krahasim me vitin 2008). Po ashtu, nëse krahasojmë lëvizjet e mallrave nga Kosova për disa vjet me radhë (në aspektin afatgjatë) vërejmë se ka trend të ngritjes në hapësirën e BE-së dhe rënie kundrejt vendeve CEFTA. Ndërkaq, importet në përgjithësi ngelin me strukturë të njëjtë si nga BE ashtu edhe vendet CEFTA.

Tabela 5: Partnerët kryesorë tregtarë të Kosovës (në %)

		2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
BE	Eksporti	41.7	29.3	38.8	38.2	42.6	47.8	43.1
	Importi	28.4	39.9	38.0	34.8	35.2	36.2	39.0
CEFTA	Eksporti	51.3	41.6	53.0	46.7	41.3	30.9	32.3
	Importi	45.6	34.7	38.0	41.1	36.7	37.5	35.7
Te tjerë	Eksporti	7.0	29.1	8.2	15.1	16.1	21.3	25.2
	Importi	26.0	25.4	24.0	24.1	28.1	26.2	25.0

Burimi: Enti Statistikor i Kosovës (2009)

3.4.1 Tregtia me vendet e BE-së

Qarkullimi tregtar me BE-në përbën pjesën më të rëndësishme të shkëmbimeve tregtare të Kosovës, me rreth 39.3 për qind të gjithë tregtisë së jashtme për vitin 2009. Prandaj, BE-ja paraqet partnerin kryesor tregtar të Kosovës. Kështu, gjatë vitit 2009 importet nga vendet e BE-s ishin mbi 755 milionë Euro ose 39 për qind e importeve të përgjithshme, përkatësisht reflektohet rritje prej 7.5 për qind krahasuar me vitin 2008.

Eksportet e Kosovës me vendet e BE-27 arritën mbi 71 milionë Euro, ose rreth 43 për qind e eksporteve të përgjithshme, përkatësisht reflektohet rënie prej 24 për qind në krahasim me atë të vitit 2008. Sa i përket këmbimit me vendet e BE-së, Italia prin si vendi më atraktiv për eksport, duke mbuluar 65 për qind të eksporteve të Kosovës në BE si dhe 28 për qind e eksporteve të përgjithshme. Viti 2009 shënoi rritje të konsiderueshme të eksporteve të Kosovës drejt Italisë (me rreth 81për qind). Po ashtu, importet e Kosovës nga Italia shënuan rritje me rreth 17 për qind, krahasuar me një vit më parë.


Sa i përket eksporteve pas Italisë, Gjermania renditet si e dyta (me rritje të eksporteve për 5 për qind). Si vend tjetër atraktiv në eksportet e Kosovës është Belgjika, e cila renditet e treta, mirëpo në mënyrë të veçantë bie në sy një rënie tepër e lartë e eksporteve të Kosovës në drejtim të këtij vendi. Eksportet drejtë këtij shteti kanë shënuar rënie mbi 80 per qind dhe mbulon vetem 7 për qind të eksporteve të përgjithshme në vendet e BE-së, përkundër vitit 2008 kur ka mbuluar 30 për qind të eksporteve në BE ose 3 për qind eksporteve të përgjithshme 2009. Arsyet për këto zhvillime janë të lidhura me rënine e kërkesës si pasojë e krizës financiare dhe është e besueshme se rikthimi në këto tregje është i mundur me kalimin e krizës. Si destinacion tjetër me rëndësi në eksportet e Kosovës llogaritet të jetë edhe Sllovenia dhe Bullgaria që të dyja së bashku përbëjnë 3.3 për qind të eksporteve të përgjithshme.

Po të njëjtat vende janë, gjithashtu, burimet kryesore të importeve, mirëpo me një renditje ndryshe; Gjermania është vendi i BE-së nga i cili importohet më së tepërmi, duke mbuluar rreth 32.5 për qind të totalit të importeve të BE-së në Kosovë, ndjekur nga Italia, Greqia dhe Sllovenia. Mallrat me origjinë nga Greqia kanë shënuar rënie për 3 për qind dhe mbulojnë 4 për qind të importeve të përgjithshme të Kosovës. Ndërsa sa i përket eksporteve kanë shënuar rënie drastike prej 97 për qind në raport me vitin paraprak.

Figura 4: Tregjet kryesore eksportuese dhe importuese te BE-së (2002 – 2009)


Italia (€000, % e totalit)

	Eksporti	%	Import	%	Bilanci
2002	7,525	27.3	25,818	3,0	-18,293
2003	6,245	17.5	35,625	3,7	-29,380
2004	5,536	9.8	44,525	4,2	-38,989
2005	5,668	10.1	49,555	4,3	-43,887
2006	12,654	11.4	52,461	4,0	-39,807
2007	9,672	5.9	57,678	3,7	-48,006
2008	25,485	12.8	74,385	3,9	-48,900
2009	46,217	27.9	87,645	4.5	- 41,428




Gjermania (€000, % e totalit)

	Eksporti	%	Import	%	Bilanci
2002	2,486	9,0	33,207	3,9	-30,721
2003	3,793	10,6	54,123	5,6	-50,330
2004	3,262	5,8	78,247	7,4	-74,985
2005	5,965	10,6	123,763	10,7	-117,798
2006	3,952	3,6	122,652	9,4	-118,700
2007	16,190	9,8	155,031	9,8	-138,841
2008	7,205	3,6	196,627	10,2	-189,422
2009	7,563	4,5	246,119	12,7	-238,556



Greqia (€000, % e totalit)

	Eksporti	%	Import	%	Bilanci
2002	199	0.7	55,424	6.5	-55,225
2003	1,776	5	72,905	7.5	-71,129
2004	4,262	7.5	68,515	6.4	-64,253
2005	5,522	9.8	44,027	3.8	-38,505
2006	3,914	3.5	37,614	2.9	-33,700
2007	8,400	5.1	63,737	4	-55,337
2008	10,851	5.5	81,403	4.2	-70,552
2009	240	0.14	79,106	4	-78,866



3.4.2 Tregtia me vendet CEFTA

Qarkullimi tregtar me vendet e rajonit (anëtare në CEFTA), në vitit 2009, janë në vlerë mbi 745 milionë euro. Nga kjo vlera e importit është 692 milionë euro ose 35.7 për qind nga vlera e përgjithshme e importit. Ky tregues shënon rënie të importit me këto vende për 3.5 për qind krahasuar me vitin 2008. Eksportet me destinacion vendet anëtare të CEFTA kapën vlerën mbi 53 milionë euro ose 32.3 për qind nga vlera totale e eksporteve, vlerë e cila tregon ecure negative nga se është më e ulët për 13 për qind në raport me vitin 2008. Si destinacion kryesor eksportues në vitin 2009 është Shqipëria, duke mbuluar 49 për qind të eksporteve në raport me vendet e rajonit, pjesëmarrëse në CEFTA dhe 16 për qind pjesëmarrje në eksportet e përgjithshme. Importet nga Shqipëria mbesin ende në nivel të ulët në raport me disa vende të rajonit nga e cila mbulohet 8 për qind e importeve të përgjithshme nga CEFTA dhe 3 për qind pjesëmarrje në importet totale.

Sa i përket strukturës së shkëmbimeve tregtare ato ende mbeten të njëjta si me atë të viteve të mëparshme. Kryesisht në Shqipëri janë eksportuar produkte si: mbeturina hekuri, çimento, produkte bujqësore/ushqimore pije dhe produkte të tjera. Ndërsa janë importuar produkte hekuri dhe çeliku, derivate të naftës, mobile dhe është këmbyer rrymë elektrike.

Maqedonia ende mbetet partner i rëndësishëm tregtar i Kosovës si në import ashtu edhe në


eksport, vend nga i cili mbulohet 42 për qind e importeve të përgjithshme dhe 32 për qind e eksporteve të përgjithshme në nivelin e vendeve anëtare pjesëmarrëse në CEFTA, (11 për qind në mbulimin e eksportit, 15 për qind në mbulimin e importit të përgjithshëm të Kosovës). Nafta dhe derivatet e naftës kanë qenë produkti kryesor i cili është importuar nga Maqedonia. Për më tepër, nga Maqedonia janë importuar edhe produkte hekuri dhe çeliku, pajisje elektrike, produkte ushqimore etj. kurse, janë eksportuar produkte me bazë metali, produkte ushqimore, pije, pajisje elektrike dhe produkte të tjera.

Tregtia e Kosovës me Serbinë gjatë vitit 2009 u karakterizua me rritjen e importeve dhe rënien e eksporteve krahasuar me një vit më parë. Eksportet e Kosovës në Serbi shënuan ulje për 64 për qind në raport me vitin 2008 duke përbërë 2 për qind të eksporteve të përgjithshme të Kosovës. Kjo rënie e eksporteve ishte rezultat i bllokadës së produkteve kosovare nga ana e Serbisë, që nga dhjetori i vitit 2008. Në anën tjetër, importet nga Serbia mbulojnë 11 për qind të importeve të përgjithshme të Kosovës. Produktet kryesore të importuar nga Serbia janë materialet ndërtimore, drithërat, vajrat ushqimore, pijet dhe produktet e tjera ushqimore.

Figura 5: Tregjet kryesore eksportuese dhe importuese CEFTA (2002 – 2009)


Shqipëria (€000, % e totalit)

	Eksporti	%	Import	%	Bilanci
2002	1,420	5.1	48,077	5.6	-46,657
2003	1,798	5	8,996	0.9	-7,198
2004	1,793	3.2	20,237	1.9	-18,444
2005	5,784	10.3	18,093	1.6	-12,309
2006	12,645	11.4	23,108	1.8	-10,463
2007	20,799	12.6	35,262	2.2	-14,463
2008	21,113	10.6	59,632	3.1	-38,519
2009	26,181	16	58,384	3	-32,203




Maqedonia (€000, % e totalit)

	Eksporti	%	Import	%	Bilanci
2002	3,396	12.3	146,205	17.1	-142,809
2003	6,945	19.5	141,735	14.6	-134,790
2004	9,641	17	149,218	14	-139,577
2005	10,828	19.2	220,148	19	-209,320
2006	9,734	8.8	257,754	19.7	-248,020
2007	17,384	10.5	237,895	15.1	-220,511
2008	20,046	10.1	346,536	18	-326,490
2009	17,354	10.5	291,839	15	-274,485



	Eksporti	%	Import	%	Bilanci
2002	4,745	17.2	193,840	22.7	-189,095
2003	6,754	19	156,410	16.1	-149,656
2004	10,060	17.8	161,281	15.2	-151,221
2005	8,158	14.5	152,257	13.2	-144,099
2006	20,910	18.9	191,053	14.6	-170,143
2007	19,280	11.7	222,534	14.1	-203,254
2008	9,893	5	208,951	10.8	-199,058
2009	3,504	2	210,901	11	-207,397



Burimi: Enti Statistikor i Kosovës (2009)

3.4.3 Tregtia me vendet e tjera të botës

Ndonëse mbi 74 për qind e tregtisë së Kosovës është e orientuar drejt vendeve të BE-së dhe CEFTA-s, gjatë vitit 2009, Kosova ka shkëmbime tregtare edhe me një pjesë të vendeve tjera të botës. Ndër këto vende vlen të përmendet Kina, prej të cilës Kosova importon mbi 6 për qind të importeve të përgjithshme (me një rritje vjetore prej 6 për qind) dhe Turqia, vend nga i cili importohen gjithashtu mbi 7 për qind të produkteve të përgjithshme (me rritje vjetore prej 10 për qind).

Zvicra dhe Turqia janë partnerët kryesorë në këtë grup-kategori sa i përket eksporteve ku këto dy vende së bashku përfshijnë 10 për qind të eksporteve të përgjithshme. Eksportet e Kosovës në drejtim të Zvicrës llogaritet të jenë 10 milionë €, tregues i cili mbulon mbi 6 për qind të eksporteve të përgjithshme (më i lartë për 42 për qind se në vitin paraprak), përderisa importet mbulojnë vetëm 1 për qind të importeve të përgjithshme (më i ulët për 32 për qind se në vitin 2008). Gjithashtu viti 2009 shënoi rritje të konsiderueshme të eksporteve të Kosovës drejt Turqisë (mbi 100 për qind), duke mbuluar 4 për qind të totalit të eksporteve.

3.5 Struktura e eksporteve dhe importeve sipas pikave doganore


Nga të dhënat e eksportit dhe importit, të realizuar nëpër pikat doganore të Kosovës, del se përqindja më e lartë e qarkullimit arrin në pikën doganore të Hanit të Elezit, si në strukturën e eksportit, ashtu edhe në atë të importit. Një përqindje e ekuilibruar, si në eksport ashtu edhe në import është shënuar në pikën doganore në Pejë, ndërsa sa i përket pikave të tjera doganore ekziston dallimi midisi lëvizjeve të eksportit kundrejt importit.

Pikat Doganore	Importi	% në import	Eksporti	% në eksport
Aeroporti	131,040,449	6.8	3,533,687	2.1
Hani i Elezit	685,973,502	35.4	95,844,852	58.0
Vërmica	114,557,226	5.9	21,900,866	13.2
Inter Evropa	152,974,065	7.9	700,092	0.4
Peja	248,982,873	12.9	19,705,048	11.9
Mitrovica	257,175,774	13.3	12,653,101	7.7
Podujeva	219,773,816	11.4	3,529,746	2.1
Dheu i Bardhë	74,058,811	3.8	460,981	0.3
Energjia elektrike	51,004,697	2.6	6,999,215	4.2
Totali	1,935,541,213	100.0	165,327,587	100.0

Burimi: Enti Statistikor i Kosovës (2009)

Eksporti më i madh është realizuar në pikën doganore të Hanit të Elezit, me një përqindje prej 58 për qind, pastaj kemi pikën doganore në Vërmicë ku eksporti i mallrave arrin në një përqindje prej 13.2 për qind, vijuar me pikën doganore në Pejë prej 11.9 për qind, si dhe në Mitrovicë prej 7.7 për qind. Pikat e tjera doganore kanë një përqindje relativisht të ulët (Figura 6).


Figura 6: Eksporti sipas përqindjes nëpër pikat doganore



Burimi: Enti Statistikor i Kosovës (2009)

Ndërsa sa i përket importit, më së tepërmi është importuar përmes pikës doganore të Hanit të Elezit, prej 35.4 për qind, pastaj nga Mitrovica me 13.3 për qind, nga Peja me 12.9 për qind, si dhe nga Podujeva prej 11.4 për qind (Figura 7).

Figura 7: Importit sipas përqindjes nëpër pikat doganore



Burimi: Enti Statistikor i Kosovës (2009)

Siç shihet në Tabelën numër 6, një përqindje, (2.6 për qind e importit dhe 4.2 për qind e eksportit), për vitin 2009, zë edhe energjia elektrike e cila transmetohet përmes rrjetit elektrik në Kosovë.

3.6 Mënyrat e transportimit të mallrave

Transporti i mallrave është një dimension mjaft problematik. Kosova edhe pse është vend mjaft i hapur për qarkullim të mallrave dhe shërbimeve ka lidhje relativisht të kufizuara me rajonin dhe gjetiu. Andaj, në këtë kontekst, duhet theksuar se të gjitha mënyrat e tjera të transportit të mallrave, jashtë atij rrugor, vihen fare pak në shfrytëzim. Për t'u përgjigjur me efikasitet kërkesës së sektorit privat është i nevojshëm përmirësimi i lidhjeve me korridoret transportuese rajonale, si domosdoshmëri për tregti dhe për zhvillimin ekonomik në tërësi.

Sikurse vihet re nga tabela e mëposhtme që pasqyron lëvizjen e mallrave sipas mënyrës së transportit, pjesa më e madhe e produkteve tregtohet përmes transportit rrugor, përmes së cilit realizohen 93 për qind e eksporteve dhe mbi 85 për qind e importeve të produkteve.

Vlen të theksohet se një rëndësi të veçantë për ekonominë e Kosovës ka ndërtimi i autostradës që lidh Kosovën me portin e Durrësit në Shqipëri, sepse me krijimin e mundësisë për dalje në det është bërë i mundur edhe shfrytëzimi i transportit detar. Kjo do t'i mundësojë ekonomisë së Kosovës përfitime në kuptim të uljes së shpenzimeve të transportit, meqë transporti detar është jashtëzakonisht më i lirë dhe më me pak komplikime se sa ai rrugor.

Tabela 7: Eksportet dhe Importet sipas menyres se transportit

	2008		2009	
	Vlera	%	Vlera	%
Transporti detar	139,669	0.07	3,992	0.00
Transporti hekurudhor	6,637,816	3.34	1,444,292	0.87
Transporti rrugor	181,178,755	91.29	154,137,095	93.23
Transporti ajror	1,123,157	0.57	1,805,088	1.09
Dergese postale	1,146,223	0.58	937,906	0.57
Transporti i kombinuar	0	0.00	0	0.00
Instalimet transportuese fikse ⁴	8,237,507	4.15	6,999,215	4.23
Gjithsejt Eksportet	198,463,128	100.00	165,327,587	100
Transporti detar	371,258	0.02	470,747	0.02
Transporti hekurudhor	122,812,882	6.37	106,459,444	5.50
Transporti rrugor	1,689,674,050	87.63	1,713,828,463	88.55
Transporti ajror	29,275,897	1.52	33,149,797	1.71
Dergese postale	6,416,679	0.33	11,328,862	0.59
Transporti i kombinuar	22,111,036	1.15	19,147,777	0.99
Instalimet transportuese fikse	57,541,187	2.98	51,098,473	2.64
Transporti përmes lumenjve	33,361	0.00	57,650	0.00
Gjithsejt Importet	1,928,236,351	100.00	1,935,541,213	100

Burimi: Enti Statistikor i Kosovës (2009)

3.7 Shërbimet dhe tregtia e shërbimeve

Në dekadat e fundit, lëvizja e mallrave, shërbimeve dhe kapitalit jashtë kufijve shtetërorë është zhvilluar në masë të madhe, duke përsheptuar nevojën për ndryshime thelbësore teknike dhe rregullative. Megjithatë, vlen të theksohet se disa nga sektorët e shërbimit, në veçanti financat ndërkombëtare dhe transportit detar, kanë qenë kryesisht të hapur për shekuj, si komponentë të nevojshëm të tregtisë së mallrave.

Prej kohësh shumë shërbime të tjera konsiderohen si veprimtari e brendshme që zhvillohet brenda vendit, mirëpo duke pa nevojën dhe rëndësinë e tyre ato janë bërë gjithnjë e më shumë ndërkombëtare. Kjo tendencë zgjerohet për shkak të futjes së transmetimeve të reja teknologjike (p.sh. elektronike bankare, arsimore, shëndetësore, të telefonisë, postare etj).

Me qëllim të zgjerimit të sistemit të tregtisë shumëpalëshe në sektorin e shërbimeve si rezultati i negociatave u nënshkrua një marrëveshje e quajtur Marrëveshja e Përgjithshme mbi Tregtinë në Shërbime (GATS), që është një traktat i Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT), i cili hyri në fuqi në janar të vitit 1995. Të gjithë anëtarët e OBT-së janë nënshkrues të GATS. Marrëveshja GATS mbulon katër mënyrat e furnizimit me shërbime në tregtinë ndërkombëtare:

⁴Në kuadër të instalimet transportuese fikse realizohet këmbimi i energjisë elektrike me vendet tjera.

- Furnizimi ndërkufitar, ku shërbimi i dorëzohet një individ/subjekti brenda një territori nga një individ/subjekt i një territori tjetër, (furnizuesi dhe konsumatori qëndrojnë në territorin e tyre p.sh. shërbimet bankare të transmetuar përmes telekomunikimit ose mail-it);
- Konsumi jashtë shtetit, i referohet situatave ku një konsumator i një vendi lëviz në një vend tjetër për ta marrë një shërbim (p.sh. shërbim turistik);
- Përfaqësimi tregtar - apo prania komerciale që nënkupton se një furnizues shërbimi i një vendi krijon një prani territoriale, duke përfshirë pronësinë apo lokale me qira, në një tjetër territor për të ofruar një shërbim (p.sh. degët e brendshme të kompanive të sigurimit të huaj, zinxhirët hotelierë etj.);
- Lëvizja e njerëzve - furnizimi me shërbime bëhet me praninë e personave fizikë të një vendi që hyn në territorin e një vendi tjetër (p.sh. kontabilistët, mjekët, mësuesit, etj.).

Në Kosovë sektori i shërbimeve është në fazën e rritjes dhe zhvillimit të vazhdueshëm në të cilën janë përfshirë disa fusha me rëndësi në zhvillimin ekonomik të cilat ofrojnë zgjidhje inovative për çështjet më komplekse të bizneseve. Megjithatë, zhvillimi i teknologjive të informacionit dhe internetit kanë zgjeruar një sërë aktiviteteve tregtare edhe në Kosovë lidhur me tregtinë e prodhimit të shërbimeve që përfshijnë një varg aktiviteteve komerciale.

Potencialet eksportuese të shërbimeve në Kosovë llogariten të jenë në lëmin e teknologjisë informative dhe të telekomunikimeve, në komunikime mobile, televizion kabllor digjital, internet dhe media, konsulentë biznesi dhe marketingu, konsulentë për resurse njerëzore, menaxheriale etj.

Tani institucionet e Kosovës janë duke i bërë përgatitjet për fillimin e implementimit të Direktivës së Shërbimeve 2006/123/EC. Në këtë drejtim MTI-ja ka filluar edhe ngritjen e kapaciteteve, duke qenë pjesë e seminareve që kanë të bëjnë me këtë fushë.

Tregu i shërbimeve, gjegjësisht shërbimet ndërmjet vendeve anëtare të CEFTA-s janë të përcaktuara në bazë të Marrëveshjes së CEFTA-s (neni 27 dhe 29 i saj). Për ta çuar përpara punën në fushën e shërbimeve, në kuadër të CEFTA-s, është krijuar Grupi Punues mbi tregun e shërbimeve. Detyra e Grupit Punues mbi tregun e shërbimeve është që gradualisht të zhvillojë dhe të zgjerojë bashkëpunimin ndërmjet vendeve të CEFTA-s me qëllim të arritjes progresive të liberalizimit dhe hapjen reciproke të tregut të shërbimeve.

Përmbyllje

Ekonomia e Kosovës edhe vitin 2009 shënoi rritje ekonomike që reflekton më së miri proceset, zhvillimet dhe lëvizjet e aktivitetit ekonomik. Shtimi ekonomik prej 5.4 për qind në vitin 2008, përkundër krizës globale ekonomike dhe shtimi ekonomik prej 4.4 për qind gjatë vitit 2009 pasqyrojnë mjaft mirë trendin e qëndrueshëm sa i përket rritjes ekonomike, përkatësisht shtimit real të GDP-së. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2011-2013 parasheh shtim ekonomik prej 5.1 për qind deri në 6.2 për qind, në periudhën afatmesme zhvillimore.

Në kontekst të qarkullimit tregtar, me KASH parashihet që importi për periudhën 2010 – 2013 të rritet për 18.1 për qind, ndërsa eksporti për të njëjtën periudhë kohore të ketë një rritje prej 24 për qind.

Politika tregtare e Kosovës e përgatitur nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë parasheh që edhe më tutje të veprohet në drejtim të liberalizimit të tregtisë, duke marrë parasysh gjithashtu edhe racionalizimin dhe zëvendësimin e importit, lehtësimin e tregtisë dhe promovimin e eksportit.

Pjesëmarrja në organizmat rajonal dhe botëror, po ashtu, duhet të konsiderohet si shumë e arsyeshme me qëllim të rritjes së qarkullimit tregtar, shtimit të aftësive konkurruese dhe fitimit të përvojave dhe praktikave më të mira tregtare.

Zhvillimet pozitive dhe lëvizjet në avancimin e tregtisë ndërkombëtare si një proces multi-sektorial duhet të përfshijnë të gjitha ministritë, institucionet përgjegjëse dhe aktorët e tjerë relevantë për t'i implementuar politikat tregtare dhe zhvillimore.

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

339.5(496.51)“2009”

Shkëmbimet tregtare të Kosovës 2009 / Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. - Prishtinë : Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, 2010. - 22 f : ilustr. me ngjyra ; 24 cm.

Parathënie / Lutfi Zharku : f. 3

ISBN 978-9951-574-10-5

ISBN 978-9951-574-10-5